



REPUBLIKA E SHQIPERISË  
BASHKIA KRUIJË  
KESHILLI BASHKIAK

VENDIM

Nr 35 datë 30 / 04 / 2018

**“Për shpronësimin për interes publik të pronës që preket nga punimet e objektit:  
“Sistemim-Asfaltim i sheshit të bllokut nr 6 ,Fushë Krujë”**

Keshilli Bashkiak në mbledhjen e tij të datës 30 / 04 / 2018, Pasi mori në shqyrtim P/vendimin **“Për shpronësimin për interes publik të pronës që preket nga punimet e objektit:“Sistemim-Asfaltim i sheshit të bllokut nr 6 ,Fushë Krujë** mbështetur në Ligjin ligjit 139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore”,Ligjit Nr.8561, datë 22.12.1999 Për shpronësimet dhe marrjen në përdorim të përkohshëm të pasurisë pronë private për interes publik (I ndyshuar) me qëllim lirim të sheshit dhe vazhdimin e punimeve të investimit të Bashkisë Krujë , pasi nuk mund të vazhdojë asfaltimi i sheshit pa shpronësuar dhe prishur objektin

**VENDOSI:**

1 Miratimin e shpronësimit për pronën e cila pengon zbatimin e investimit të Bashkisë Krujë,si më poshtë vijon:

**Të dhëna të pronës që kërkohet të shpronësohet:**

- Sipërfaqja për shpronësim i objektit: 28m<sup>2</sup>(pjesërisht, sipas preventivit, pasi objekti është thujse i prishur totalisht).
- Sipërfaqja e truallit për shpronësim: 28m<sup>2</sup>.
- Numri i pasurisë: 3/450.
- Zona kadastrale: 1664.
- Vendodhja: lagja “Punëtori” Fushë Krujë.
- Emri i pronarit: Ismail Adem Qemolli.
- Vlera e objektit: 112,034 leke
- Vlera e truallit: 78,260 leke

2. Fondi per shpronësim do te merret nga te ardhurat e Bashkise Kruje

3Ky vendim hyn në fuqi pas konfirmimit ligjor nga Prefekti i Qarkut Durrës.

4.Ngarkohet për zbatimin e këtij vendimi Komisioni i ngritur në Bashki per kryerjen e procedurave të shpronësimit,për përgatitjen e të gjithë dokumentacionit dhe kryerjen e procedurave të përcaktuara në Ligjin nr Nr.8561, datë 22.12.1999 Për shpronësimet dhe marrjen në përdorim të përkohshëm të pasurisë pronë private për interes publik (I ndryshuar)

**KRYETARI I KËSHILLIT**

**HYSNLCACA**

